



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELFGOVERNMENT

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI – CORRUPTION AGENCY



PJESË NGA RAPORTI VJETOR
I PUNËS
SË
AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR
KORRUPSIONIT

1 JANAR -31 DHJETOR 2007

I. HYRJJE

Gjatë viteve të fundit në Kosovë është bërë gjithmone e me akut problemi i fenomeneve korruptive të cilat kanë minuar stabilitetin ekonomik, shtetin e së drejtës si dhe kanë lëkundur rrënjësisht besimin e publikut tek institucionet e reja të krijuara pas konfliktit.

AKK-ja është një organ i ri në këtë fushë dhe në fillimet e tij në ndërmarrjen e veprime konkrete kundër abuzimeve korruptive, ndërgjegjësimin për një shoqëri të pa korruptuar tek nëpunësit civil, zyrtarët e lartë, sektori publik, media dhe shoqëria civile dhe publiku në përgjithësi. Gjithashtu, është në hapat e parë për vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellët midis institucioneve, mekanizmave dhe partnerëve për të siguruar fillimin dhe kryerjen e reformave të suksesshme anti-korrupsion.

II. HISTORIKU

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit është i vetmi organ i pavarur, i konceptuar si mekanizmi themelor në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit dhe koordinimin e politikave anti-korrupsion në Kosovë. Agjensioni ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin kundër Korrupsionit (2004/34), është ngritur në korrik 2006 dhe ka filluar funksionalitetin e tij në 12 shkurt 2007.

Qëllimi dhe puna e Agjensionit është e përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit, për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e të përparuar kosovare dhe që bazohet në shtetin e së drejtës.

III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE STAFI I AGJENSIONIT

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit e organizon punën e tij në bazë të Rregullave të Brendshme të Funkcionimit të Agjensionit. Këto rregulla pasqyrojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e çdo zyrtari në secilin divizion dhe departament.

Agjensioni është i përbërë nga tre departamente, secili departament nga dy nëndivizione dhe katër zyra të veçanta. Aktualisht në mënyrë të detajuar në Agjension punojnë:

- i. në Departamentin për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative, 4 punonjës nga 12 që duhet të ketë gjithsej;
- ii. në Departamentin e Parandalimit, 3 punonjës nga 9 gjithsej;
- iii. në Departamentin e Shërbimeve Administrative, 4 punonjës nga 9 gjithsej; si dhe
- iv. një asistente ekzekutive dhe një zyrtar për prokurimet.

IV. AKTIVITETET E AGJENSIONIT

Aktivitetet e Agjensionit janë të përqendruara në tre shtylla kryesore:

- i. Zbatimi i ligjit;
- ii. Parandalimi dhe eliminimi e shkaqeve te korrupsionit; dhe
- iii. Edukimi, ngritja e vetëdijes qytetare.

i. Zbatimi i ligjit, përkatësisht:

- a. Zhvillimi e hetimeve për të gjitha rastet e dyshuara për korrupsion;
- b. Plotësimi i legjislacionit në fushën e Anti-korrupsionit.

Rastet e paraqitura në periudhën Janar – Dhjetor 2007

Krahasuar me vitin 2006, kur AKK-ja ishte në fillimet e punës së tij dhe pranë departamentit ishin depozituar një numër simbolik të informacioneve në lidhje me veprimet korruptive, vetëm gjatë shtatorit 2007 në linjën telefonike pa pagesë dhe konfidenciale, **044 082 82**, të instaluar me qëllim që qytetarët të raportojnë rastet të korrupsionit, Divizioni i Hetimeve ka marrë rreth **160** thirrje telefonike, si dhe ka pranuar **31** raste të paraqitura nga ana e qytetarëve të cilët kanë bërë kërkesën për fillimin e procedurës së hetimeve duke ofruar dëshmitë e nevojshme për hetimin e këtyre rasteve.

Në krahasim me rastet e paraqitura gjatë vitit 2006, në vitin 2007 raste kanë veçoritë karakteristike të mëposhtme:

- a. numri shumëfish më i madh i raportimeve të rasteve të dyshuara për korrupsion;
- b. dëmet e supozuara se janë shkaktuar nga veprimet korruptive llogaritet të jenë shumë më të mëdha; dhe
- c. dyshimi i implikimit në këto raste të personave të dyshuar për vepra serioze të korrupsionit nga nivele të larta të pushtetit.

Pasqyra e përgjithshme e rasteve të paraqitura në AKK

Pasqyra e mëposhtme tregon në mënyrë të përmblëdhur tabelare të dhënat mbi rastet e përmendura me sipër, tashmë të klasifikuara përkatësisht sipas institucioneve:

Institucioni	Rastet e paraqitura	Rastet e mbyllura	Rastet e dërguara në prokurori	Rastet në procedurë
Qeveria	36	15	13	8
Parlamenti	/	/	/	/
Gjykatat	35	19	14	2
Prokuroritë	1	1	/	/
Institucionet e tjera	26	13	9	4
Pushteti lokal	26	13	11	2
GJITHSEJ	124	61	47	16

*Rastet anonime 24 raste, 17 në Prokurori, 7 po hetohen ;
Vlerat e përgjithshme - pasojat ekonomike të krijuara shoqërisë rreth 30 milion.*

Fati i Informatave

Tabela 2. tregon për rrjedhën e informatave në prokuroritë publike të Kosovës:

Informata u përcillen	Numri	Të hedhura poshtë	Nën hetime
Prokurorinë Publike të Prishtinës	21	1	20
Prokurorinë Publike të Mitrovicës	1	/	1
Prokurorinë Publike të Pejës	5	1	4
Prokurorinë Publike të Prizrenit	5	4	1
Prokurorinë Publike të Gjilanit	2	/	2
Prokurorinë Publike Speciale	3	/	3
SHPK	8	/	8
Policia e UNMIK-ut	1	/	1
FIU	1	/	1
Gjithsej	47	6	41

Pesë (5) informatat e hedhura i përkasin gjyqësorit (befason shpejtësia e hedhjes), një (1) pushtetit lokal ndërsa sa i përket fazës së hetimeve ka të suspenduar, të paraburgosur (arrest shtëpiak), s'kemi informata për raste të mbyllura.

Iniciativat Legjislative

Zyrtarët e AKK-së kanë marrë pjesë në grupet punuese për drejtimin e dy ligjeve:

- Ligji për parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- Ligji për deklarimin e Kontrollin Pasurisë.
- Në bashkëpunim me ekspert të Këshillit të Evropës është punuar në Amendamentimin e Ligjit kundër Korrupsionit.

ii. Parandalimi dhe eliminimi i shkaqeve të Korrupsionit

- a. Përcjellja e pasurisë;
- b. Parandalimi i konfliktit të interesit;
- c. Përcjellja e dhuratave.

a. Deklarimi i Pasurisë së personave të Lartë Zyrtar

Institucionet	Numri i zyrtareve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Pozitat e paplotësuara	Numri i zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
Kuvendi	123	1	114	8	92.6

Presidenca	4	-	4	0	100
Qeveria	202	4	198	0	98.0
Gjykatat	316	-	310	6	98.1
Prokuroria	87	-	87	0	100
Totali	732	5	713	14	98.0

Proceduar e deklarimit të pasurisë së personave të lartë zyrtar u realizua me 98%, (14 zyrtar nuk kanë realizuar obligimin, 8 nga Kuvendi, 6 nga Gjyqësori). Masa janë marrë kundër 21 zyrtarëve (ndalesë pagash prej 20%).

b. Konflikti i Interesit

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna nga Ligji kundër Korrupsionit që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, janë ndërmarrë veprime të caktuara në pajtim me dispozitat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit. Këtu duhet pasur parasysh se Departamenti në vazhdimësi i shqyrton formularët e paraqitur të deklarimit të pasurisë për të verifikuar ekzistencën apo jo të konfliktit të caktuar të interesit tek zyrtarët e lartë publik.

Përveç shqyrtimit të formularëve të zyrtarëve të lartë, deri tani Agjensioni ka marrë informata të bazuara për ekzistencën e konfliktit të interesit për 15 zyrtar të lartë publik, dhe me anë të ndërhyrjes së Agjencionit konform dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit në Ligjin kundër Korrupsionit, është arritur shmangja nga gjendja e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, në ato raste ku janë vërejtur shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik në institucionet e Kosovës, departamenti ka ndërmarrë veprime konkrete në fushën e parandalimit të korrupsionit. Nga veprimet e ndërmarra, është rekomanduar anulimin e disa tenderëve dhe iniciativave tjera në IPVQ, para hapjes së ofertave, duke eliminuar diskriminimin e operatorëve të përgjegjshëm ekonomik. Vlera e paralogaritur e tenderëve të anuluar arrin shifrën e 7,000,000.00 (shtatë milion) Euro.

c. Pranimi i Dhuratave

Me qëllim të zbatimit të kreut të IV- të Ligjit kundër Korrupsionit që ka të bëjë me pranimin e dhuratave, Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit ka marrë masa konkrete, fillimisht për përgatitjen e një katalogu të veçantë për dhurata, ka përgatitur udhëzimet për plotësimin e këtij katalogu, si dhe është në përfundim e sipër procesi i shpërndarjes së katalogut të dhuratave dhe organizimi i konsultave mbi plotësimin e katalogut me pikat kontaktuese nëpër institucione.

Ndërkohë, departamenti po bënë një punë përgatitore për mënyrën se si do ti klasifikoj regjistrat e dhuratave që do të vijnë nga institucionet qendrore, jo më vonë se data 31 mars 2008 si dhe po punon në mënyrë intensive mbi mënyrën dhe formën e arkivimit dhe bazës së të dhënave.

iii. Edukimi

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare dhe njoftimit të publikut të gjerë me Ligjin kundër Korrupsionit si dhe me AKK-në, zyrtarët e AKK-së kanë vizituar shumë institucione qendrore dhe lokale si dhe në tryeza të ndryshme në organizimin e OSBE-së, UNDP, shoqërisë civile kemi biseduar me nëpunës, qytetarë, studentë etj. Ku gjatë vitit janë marrë më shumë se 25 takime të tilla.

AKK është një institucion i ri, zyrtarët në AKK kanë të gjithë përgatitje superiore universitare dhe një biografi të pastër, me qëllim të ngritjes profesionale të stafit të Agjencionit ne 42 trajnime kanë marrë pjesë 65 zyrtarë.

Duke e marr parasysh se procedurat e luftimit të korrupsionit janë të panjohura për ne, prandaj me qëllim të përfitimit praktik kemi vizituar institucionet simotra të shteteve që në luftën kundër korrupsionit kanë të arritura të konsiderueshme, kemi vizituar Institucionet në Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Holandë, Belgjikë (shtetërore dhe BE) dhe Letoni.

Drejtori i AKK-së ka marrë pjesë në konferencën e dytë Botërore të Institucioneve Anti-korrupsion.

V. BUXHETI

Buxheti i AKK-së sipas Ligjit të buxhetit ka qenë 412,956.00 euro.
Të shpenzuara 90% ose 336, 956.06.

Buxheti është shpenzuar sipas procedurës në fuqi, problem i veçanët kanë qenë mungesa e zyrtarëve të certifikuar për Prokurim dhe Zotim, kemi qenë të shtyrë që në këto trajnime ti dërgojmë zyrtarët të cilët kanë detyra tjera zyrtare, kështu që qasje në buxhet kemi pas tek prej muajit Mars 2007.

Buxheti është shfrytëzuar sipas kërkesës, pjesa e suficitit i përket në masën kryesore tek pagat dhe shpenzime komunale, që vlerësojmë një kursim i mirë.

Shpenzimet për telefon dhe derivate janë minimale edhe ato përbëjnë vetëm 3% të shpenzimit të përgjithshëm.

Për dreka dhe darka jashtë objektit të AKK-së nuk është shpenzuar asnjë cent

VI. PROBLEMET/VËSHTIRËSITË

Problemet kyçe me të cilat është ballafaquar Agjensioni:

- Numri i vogël i personelit;
- Pagat e shërbyesve (rrezikimi i largimit të stafit ose i mos koordinimit të ekspertëve);
- Buxheti (duke mos u aprovuar në shumën e kërkuar dhe të domosdoshme për Agjensionin);
- Koordinimi jo i mirë me Prokuroritë Publike.

VII. PLANET

Vazhdimi i punës me intensitet të plotë drejtë:

- Përgatitja e Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit;
- Pranimi të zyrtarëve të rinj (kriteret profesionale dhe morale);
- Identifikimit të veprimeve korruptive;
- Ngritja profesionale;
- Intensifikimi i takimeve edukuese.

PËRFUNDIM

Korrupsioni është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë, një sfidë që mund dhe duhet të përballohet. Jemi të ndërgjegjshëm se korrupsioni me një shtrirje të madhe ose të vogël është kërcënim serioz për institucionet demokratike dhe të drejtat e liritë themelore njerëzore.

Të ndodhur përball kleptokracisë, abuzimit me fondet, transaksionet e paligjshme, nepotizmit, keqpërdorimit të drejtësisë, e shume dukuri te tjera të korrupsionit te njohura tash me për shoqërinë tone, le te përpiqemi qe ne si Agjension dhe shoqëria Kosovare në përgjithësi, ti japim grushtin e forte te cilin edhe e meriton.

Përkundër të gjitha vështirësive dhe problemeve me të cilat ne si Institucion jemi ballafaquar, ngandonjëherë edhe me përkrahjen joadekuate nga Institucionet e ndryshme, me vullnetin dhe dëshirën tone për ta luftuar këtë te keqe jemi përpjekur qe çdokund dhe çdoherë te jemi ne shërbim të qytetarit,

Shpresoj që gjatë këtij viti lufta kundër korrupsionit do të jetë në listën e prioriteteve te të gjitha institucioneve, sinjalet e para janë shpresëdhënëse.

Shfrytëzojë rastin qe juve përfaqësuesve të mediave të ju falënderoj sinqerisht për mbështetjen e juaj profesionale.